

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

GJYQTARE: REXHINA MERLIKA

Asistuar prej sekretares gjyqësore Manjola Islamaj, në Tiranë, sot më datë 17.06.2015, me pjesëmarrjen në gjykim të prokurores Suela Sallavaçi, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KËRKUES:

Z. M. i biri i M. dhe i M., lindur në Krujë, banues në rruga “...” Tiranë, përfaqësuar në gjykim me prokurë të posaçme Nr.298 Rep.Nr.146/2 Kol. datë 02.06.2015 nga Av.Genc Ismaili, me licensë Nr.798, nipt K72104004H.

N. M. i biri i M.t dhe i M., lindur në Krujë, banues në Tiranë, përfaqësuar në gjykim me prokurë të posaçme Nr.... Rep.Nr.... Kol. datë 02.06.2015 nga Av.Genc Ismaili, me licensë Nr.798, nipt K72104004H.

OBJEKTI:

Heqjen e Sekuestros Preventive të vendosur me vendimin Nr..... Regj. datë 04.02.2015, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për bllokimin e llogarive bankare të Z. M., N.

M., M. R., A. M. dhe M.

M..

BAZA LIGJORE: Neni 274/3 i K. Pr. Penale.

Gjykata pasi u njoh me materialet e çështjes, dëgjoji palën kërkuese e cila kërkoi: Pranimin e kërkesës; Prokuroren, e cila kërkoi: Pranimin e kërkesës

VËREN

Pala kërkuese më kërkesë drejtuar gjykatës ka kërkuar: Heqjen e Sekuestros Preventive të vendosur me vendimin Nr..... Regj. datë 04.02.2015, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për bllokimin e llogarive bankare të Z. M., N. M., M. R., A. M. dhe M. M..

Nga shqyrtim i kërkesës rezultoi e provuar se: Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë me datë 03.02.2015 është regjistruar procedimin penal Nr..... për veprën penale të ***“Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”***, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të pastrimit parave, me anë të shkresës me Nr....., datë 30.01.2015, ka lëshuar urdhërin me Nr.12, për bankën “Bankës TIRANA”, për bllokim të përkohshëm të transaksioneve të shtetasve; Z. M., i biri i M. dhe M., i datëlindjes 02.05.19...., lindur në Laç dhe banues në rrugën “...”, Tiranë; N. M., i biri i M. dhe M., i datëlindjes 19.02.19..., lindur në Laç dhe banues në rrugën “...”, Tiranë; A. M. M., e datëlindjes 07.08.19...; M. K. M., e datëlindjes 22.10.19...; M. K. R., e datëlindjes 20.09.19..

Nga informacionet e marra për shtetasin Z. M. dhe vëllain e tij N. M., dyshohet se janë marrë me trafik lëndësh narkotike në Itali kryesisht në zonën e Milanos dhe vëllai i tij është arrestuar dhe dënuar në Itali për trafik lëndësh narkotike. Lidhur me aktivitetin e këtyre shtetasve dhe bashkëpunëtorëve të tyre në Itali i është kërkuar informacion Zyrës Qëndrore Interpol Tirana, me anë të shkresës me Nr.....k, po kështu i është kërkuar informacion dhe Zyrës Ndërlidhëse së Policisë Italiane me Shqipërinë, “Interforce”, mbi aktivitetin e tyre kriminal në Itali.

Në kundër të këtij investigimi kanë rezultuar se në emër të shtetasit Z. M. dhe familjarëve të tij janë të rregjistruar në QKR aktivitetet e biznesit si dhe rezultojnë llogari në banka e Tiranës për të cilat është disponuar me vendimin Nr..... Regj. datë 04.02.2015. Nga materiali procedues gjykata ka krijuar bindjen se ka të dhëna të bazuara se llogarite bankare dhe dokumentat përkatëse kanë lidhje me veprën penale për të cilën ka filluar procedimi penal dhe mbi këtë bazë me vendimin Nr.....Regj. datë 04.02.2015 ka vendosur: Sekuestrimin në Banka Tirana të gjithë llogarive bankare dhe dokumentacionit bankar në emër të shtetasve Z. M., N. M., M. R., A. M. dhe M. M..

Pala kërkuese parashtroi se: Në kushtet kur nga ana e prokurorisë janë kryer veprimet e duhura dhe nuk ka rezultuar ndonjë arsye e bazuar për llogari të procedimit penal të nisur, dhe në kushtet kur për vazhdimin e aktivitetit tregtar të këtyre shtetasve, nevojat familjare por edhe qarkuimin e aseteve apo mjeteve të xhiros të shoqërisë tregtare që ata zotërojnë kërkojnë heqjen e sekuestros. Mendojme se kanë ndryshuar kushtet, pasi asnjë rrethanë apo prove ligjore nuk provohet pretendimi i akuzës, për veprën penale të pretenduar, pasi ankuesit kanë akitvitet tregtar të rregullt sipas ligjit.

Prokurorja e çështjes lidhur me kërkimin parashtroi se: Ne jemi njohur me provat e paraqitura nga kërkuesit ne lidhje me sekeustrimet e pasurisë së shtetasve Z. dhe N. M., konstatojmë se kontratat e kryera nga shtetasi Z. M. janë kryer para noterëve dhe kontrata e sipërmarrjes me gjithëse nuk është nënshkruar para noterit ëshë një kontratë e mirëpërcaktuar që tregon burimin e të ardhurave në lidhje me punimet e kryera. Gjithashtu nga hetimet e kryera nga ana jonë deri në këtë fazë të hetimit nuk rezulton që të jetë provuar fakti se pasuritë e sekuestruara nga ana jonë kanë lidhje me ndonjë aktiveitet kriminal të mundshëm të kryer nga këta shtetas. Në këto kushte jam dakort me kërkesën e paraqitur nga kërkuesit, pasi **nuk është provuar që kërkuesit të kenë kryer veprime të kundraligjshme që mund t'i inkriminonin. Jam dakort për heqjen e masës së sekuestros të vendosur me kërkesën tonë nga gjykata me vendimin Nr.....**

Gjykata lidhur me kërkesën i referohet nenit 274 të K.Pr.Penale sipas të cilit parashikohet se: *“1. Kur ka rrezik që disponimi i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar. 2. Sekuestroja mund të vendoset dhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurise tjetër që lejohet të konfiskojë, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3 Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, heq sekuestron”.*

Në vendimarrjen e saj gjykata duke qënë në fazën fillestare të hetimeve gjykata ka vendosur këtë masë në kushtet emergjente duke marrë parasysh të dhënat të cilat në fakt kanë qënë në fazën e verifikimeve dhe që sipas parashtrimeve të prokurorës rezulton se nga hetimit e mëtejshme nuk rezulton që të jetë provuar fakti se pasuritë e sekuestruara kanë lidhje me ndonjë aktiveitet kriminal të mundshëm të kryer nga këta shtetas.

Nga ana tjetër nga pala, kërkuese u paraqitën prova shkresore sipas të cilave janë një sërë kontratash të cilat tregojnë për një veprimtari tregtare, konkretisht të pasqyruar në kontrata sipërmarrje si dhe nënsipërmarrje që tregojnë burimin e të ardhurave.

Gjykata në vendosjen e sekuestros ka marrë parasysh natyrën komplekse të veprime hetimore brenda dhe jashtë vendit, konfirmuar nga shkresat përkatëse dërguar autoriteteve italiane, por që nga prokuroria në këtë seancë rezulton se nuk ka ardhur asnjë e dhënë imlikuese e këtyre personave.

Sa më sipër gjykata konkludon se kërkesa është e bazuar në ligj dhe në prova, prandaj duhet pranuar duke disponuar me heqjen e sekuestros dhënë me vendimin Nr..... datë 04.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në të të gjithë llogaritë e bankare dhe dokumentacionin bankar në emër të shtetasve Z. M., N. M., M. R., A. M. dhe M. M..

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenin 274/3 të Kodit të Procedurës Penale;

V E N D O S I

-Heqjen e sekuestros dhënë me vendimin Nr..... datë 04.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në të të gjithë llogaritë e bankare dhe dokumentacionin bankar në emër të shtetasve Z. M., N. M., M. R., A. M. dhe M. M..

-Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tirane, brenda 10 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e shpalljes së tij.

-U shpall sot, në Tiranë me dt. 17.06.2015.

S E K R E T A R E

G J Y Q T A R E

MANJOLA ISLAMAJ

REXHINA MERLIKA